

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 11485/11

**FEDERATA SHQIPTARE E MUNDJES DHE
VIRON BEZHANI KUNDËR SHQIPËRISË**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 19 shtator 2023, si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 11485/11) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar pranë Gjykatës sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) më 16 shkurt 2011 nga Federata Shqiptare e Mundjes (*shoqata “Federata Shqiptare e Mundjes”* – “federata” ose “kërkuesi i parë”) regjistruar pranë gjykatës kompetente në vitin 2009 dhe me seli në Tiranë dhe z. Viron Bezhani, i lindur në vitin 1958, banues në Tiranë (“kërkuesi i dytë” ose bashkërisht “kërkuesit”). Ata përfaqësohen nga z. A. Hajdari, avokat me licencë në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar fillimisht nga Agjentja znj. A.Hiçka, dhe më pas nga Agjenti z. O.Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit; parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për mosekzekutimin nga autoritetet e brendshme të një vendimi arbitrar që kishte shpallur të pavlefshëm zgjedhjet e mbajtura nga federata.

A. Konteksti

2. Kërkuesi i parë është një shoqatë qëllimet e të cilës përfshijnë, mes të tjerave, bashkimin në një federatë të të gjitha klubeve dhe shoqatave shqiptare në fushën e mundjes, organizimit të konkurseve kombëtare të mundjes dhe përfaqësimit të komunitetit të mundjes brenda dhe jashtë vendit. Duket se për të përmbushur këto qëllime, kërkuesi i parë gëzon të drejtën ekskluzive që i është dhënë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (“Ministria”).

3. Në periudhën në fjalë, kërkuesi i dytë ishte sekretari i përgjithshëm i Federatës.

B. Vendimi i Komisionit të Arbitrazhit Sportiv

4. Më 1 mars 2009, disa anëtarë të federatës zhvilluan një mbledhje të jashtëzakonshme ku A.Z dhe A.H u zgjodhën President dhe Sekretar i Përgjithshëm i federatës përkatësisht (“zgjedhjet e kontestuara”).

5. Më 3 mars 2009, ministri miratoi A.H si sekretar të përgjithshëm të federatës. Vendimi i tij, i dhënë në formën e një urdhri, u bazua në nenin 14, pika 2, të Ligjit për Sportin (ligji nr. 9376, i ndryshuar) ku parashikohej se çdo ndryshim i synuar i statutit të “federatave” (d.m.th shoqatave siç është kërkuesi i parë, të cilit i është dhënë e drejta ekskluzive për të bashkuar në federatë shoqata dhe klube të tjera në një sport të caktuar) do t’i paraqitet për miratim ministrisë.

6. Më 11 mars 2009, A.B, kërkuesi dhe kërkuesi i dytë, në cilësitë e tyre pretenduara, përkatësisht president dhe sekretar i përgjithshëm i federatës, kundërshtuan ligjshmërinë e zgjedhjeve të

kontestueshme përpara Komisionit të Arbitrazhit Sportiv (“KAS”) i cili është forumi i brendshëm i arbitrazhit në fushën e sportit.

7. Më 2 prill 2009, KAS-i pranoi padinë dhe shpalli të pavlefshme zgjedhjet e mbajtura më 1 mars 2009 (“vendimi i KAS-it”). Në vendim nuk tregohej se kush ishte i padituri në proces. Tribunali i arbitrazhit i referohej kërkuarit të dytë si sekretar i përgjithshëm i federatës dhe konstatoi që mbledhja e jashtëzakonshme e datës 1 mars 2009 ishte thirrur dhe organizuar nga persona të paautorizuar.

8. Më 9 prill 2009, kërkuari i dytë i dërgoi ministrisë vendimin e KAS-it.

9. Më 17 korrik 2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nxori një *urdhër ekzekutimi* që parashikonte zbatimin e vendimit të KAS-it. Më 31 korrik 2009, Zyra Përmbartimore Tiranë filloi procedurën e ekzekutimit dhe i kërkoj ministrisë që të zbatonte vendimin e KAS-it.

10. Më 2 shtator dhe 24 nëntor 2009 përmbartuesi i kërkoj përsëri ministrisë që të zbatonte vendimin e KAS-it dhe të shpallte pavlefshmërinë e zgjedhjeve të 1 marsit 2009.

11. Më 2 dhjetor 2009, ministria informoi përmbartuesin që sipas ministrisë i padituri në proces ishte federata, jo ministria, prandaj ajo nuk ishte e detyruar që të merrte masa në lidhje me vendimin e KAS-it.

12. Në korrespondencën në vijim, të 8 dhjetorit 2009, drejtuar përmbartuesit, ministria u shpreh që federata ishte një subjekt i pavarur privat, prandaj ministria nuk mund të ndërhynte me zbatimin e vendimit të KAS-it i cili, sipas saj, duhej të ishte zbatuar nga organet drejtuese të federatës.

C. Proceset gjyqësore

13. Më 30 tetor 2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vëren që kërkuari i dytë nuk ishte paraqitur në seancën dëgjimore, në lidhje me kundërshtimin e tij ndaj urdhrit të ministrisë për të miratuar A.H si sekretar të përgjithshëm të federatës (shihni paragrafin 93më sipër). Në këto rrethana e pushoi procesin.

D. Ngjarjet e mëpasshme

14. Më 30 janar 2010 u mbajt një tjetër mbledhje e përgjithshme e federatës dhe zgjodhi kërkuarin e dytë si president të federatës.

15. Më 17 maj 2010, në një korrespondencë me Bashkinë e Laçit, ministria u shpreh që: “njeh, financon dhe i jep të drejtën të përfaqësojë Shqipërinë në konkurse brenda dhe jashtë vendit [federatës] me president [A.Z.] dhe sekretar të përgjithshëm [A.H].”.

16. Në korrespondencën e 14 qershorit 2010, kërkuari i dytë u ankua përpara ministrisë që ata nuk e kishin miratuar atë akoma si president të federatës.

17. Më 6 tetor 2010, ministria informoi organet e federatës që zbatimi i vendimit të KAS-it të 2 prillit 2009 ishte detyrim ligjor.

18. Në një korrespondencë tjetër të 3 dhjetorit 2010, ministria informoi federatën që ministria do të mbështeste çdo vendim të marrë nga “komuniteti i mundjes”, në lidhje me përfaqësimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Neni 6, paragrafi 1 i Konventës

19. Kërkuarit u ankuan sipas nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, që organet e ligjshme të federatës nuk njiheshin akoma në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe që vendimi i KAS-it i 2 prillit 2009 nuk ishte zbatuar *de facto*.

20. Gjykata vëren që, nisur nga mosmarrëveshjet e brendshme, mund të jetë e hapur për diskutim nëse kërkuari i dytë mund të përfaqësojë federatën dhe të depozitojë në emër të saj këtë kërkesë, ashtu siç ai bëri. Megjithatë, kjo pyetje mund të lihet e hapur sepse ankimimi gjithsesi është haptazi i pabazuar.

21. Përpara gjykatave të brendshme ose tribunaleve të arbitrazhit u shtruan pyetjet nëse zgjedhjet e 30 janarit 2010 të mbajtura nga federata ishin të ligjshme dhe nëse autoritetet shtetërore kishin dështuar me njohjen e rezultatit të tyre, dhe prandaj ato janë të papranueshme përpara Gjykatës. Prandaj qëllimi i çështjes përpara Gjykatës është i kufizuar me faktin nëse ndonjë veprim ose mosveprim i autoriteteve shtetërore ka çuar në moszbatimin e vendimit të KAS-it, të 2 prillit 2009, (shihni parimet e përgjithshme në çështjen *Sekul kundër Kroacisë* (dhjetor), nr. 43569/13, paragrafi 54, 30 qershor 2015).

22. Deklarata e ministrisë në shkresën e 17 majit 2010 (shihni paragrafin 103 më sipër) që A.Z. dhe A.H ishin zyrtarë të ligjshëm të federatës duket se anashkalon vendimin e KAS-it, i cili e kishte shpallur të pavlefshme zgjedhjen e tyre në detyrë. Parashtrimi i Qeverisë përpara Gjykatës nuk dha ndonjë shpjegim në këtë drejtim.

23. Megjithatë, edhe pse kjo korrespondencë është arsye për t'u shqetësuar, në mungesë të veprimeve ose mosveprimeve të tjera të autoriteteve shtetërore, në vetvete është e pamjaftueshme për të mbështetur përfundimin se autoritetet e brendshme kanë dështuar me zbatimin e vendimit të KAS-it.

24. Edhe pse me pak vonesë pas korrespondencës së mësipërme, autoritetet e brendshme në fund miratuan një qëndrim të qartë që vendimi i KAS-it ishte i detyrueshëm dhe që duhej të zbatohet nga organet e federatës (shihni paragrafin 105 më sipër).

25. Gjithashtu është e rëndësishme që vendimi i KAS-it ishte thellësisht deklarues dhe nuk orientonte ndonjë autoritet shtetëror që të kryente ndonjë veprim specifik. As kërkuesit nuk identifikuan ndonjë veprim që autoritetet shtetërore në mënyrë të nënkuptuar duhej të ndërmerrnin dhe nuk e ndërmorën për shkak të vendimit të KAS-it.

26. Për rrjedhojë, ankimimi në lidhje me moszbatimin e vendimit të Komisionit të Arbitrazhit Sportiv, të 2 prillit 2009, është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35, paragrafi 3(a) dhe 4, të Konventës.

B. Ankimime të tjera

27. Ankimimi i kërkuesit që moszbatimi i vendimit të KAS-it përbënte shkelje të nenit 11 të Konventës, gjithashtu, është haptazi i pabazuar për të njëjtat arsye si ato të parashtruara në paragrafët e mësipërm.

28. Kërkuesi i dytë u ankua që ai nuk e kishte marrë pagën e tij mujore si president i federatës dhe prandaj ishte shkelur neni 1, i Protokollit nr. 1 të Konventës. Megjithatë, detyrimi i federatës për të paguar kërkuesin nuk ishte pjesë e çështjeve të zgjidhura nga vendimi i KAS-it. As kërkuesi i dytë nuk filloi procesin e brendshëm për të kërkuar që t'i jepeshin pagat e tij. Për rrjedhojë, ky ankim është i papranueshëm për mosshërim të mjeteve të brendshme ligjore, në përputhje me nenin 35 § § 1 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 tetor 2023.

Olga Chernishova
ZËVENDESKANCELARE

Georgios A. Serghides
PRESIDENT

